



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:171582  
Datë: 13.06.2024  
Numri i dokumentit: 05866403

**Ac.nr.1347/2021**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dardan Kadolli, kryetar i kolegjit, Nehat Idrizi dhe Hunaida Pasuli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit H. S. adresa: fshati P., Komuna e Podujevës, kundër të paditurës NPN “V...” me pronar B. Sh. nga Podujeva, Rruga “S.” pn., të cilën e përfaqëson M. S., avokat në Podujevë, adresa: “N. G.” pn., me objekt kontesti kompensimi i dëmi, me vlerë të kontestit: 1,000.00€, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë C.nr.427/2013, i datës 27.01.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 13.06.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** e pathemeltë ankesa e paditësit H. S. nga Podujeva, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, C.nr.427/2013, datë 27.01.2021, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin C.nr.427/2013, i datës 27.01.2021, ka vendosur si në vijim: **REFUZOHET** në tërësi padia dhe kërkesëpadia e paditësit H.S. nga fshati P., Komuna e Podujevës, **si e pabazuar**, me të cilën ka kërkuar të **APROVOHET** padia dhe kërkesëpadia e paditësit H. S. nga fshati P., Komuna e Podujevës, dhe **OBLIGOHET** e paditura NPN “V.” me pronar B. Sh. nga Podujeva, Rruga “S.” pn., që ti kompensoi paditësit H. S. nga P., Podujevë, vlerën e dëmit në emër të dëmtimit të patundshmërisë me mbeturina të hedhura në ngastrën kadastrale nr....5 dhe nr..., Zona Kadastrale O. dhe P., në sipërfaqen e dëmit prej 20 ari, në shumë prej 1,000€, me kamatë ligjore nga dita e ngritjes së padisë, si dhe shpenzimet e

procedurës gjyqësore të cilat do të përcaktohen nga gjykata, të gjitha në afatin prej 15 ditësh prej ditës kur aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.” Secili pjesëmarrës në procedurë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi paditësi në afat ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo te plote te gjendjes faktike, si dhe zbatimit te gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën, aktgjykimin e atakuar ta prish dhe çështjen juridike-kontestimore ta kthej ne rishqyrtim dhe rivendosje, apo aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj dhe të aprovoj kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar.

Në shkresa të lëndës nuk mund të gjendet se i padituri ka parashtuar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa e paditësit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se pala paditëse me datë 27.05.2013 ka paraqitur padi kundër të paditurit duke kërkuar kompensimin e dëmit i cili i është bërë paluajtshmërisë së paditësit, duke i hedhur mbeturina, në shumë prej 1000€. Sipas paditësit ky dëm ka ndodhur kur është bërë asfaltimi rrugës në të cilin e paditura ka qenë si punë kryese, në atë mënyrë që mbeturinat e rrugës duke i hedhur në arën e tij. Këto mbeturina edhe pse i ka hedhur afërisht dhjetë kamionë me rrënjë, gurë, zall, nuk i ka pastruar. Prandaj në bazë të provave që ekzistojnë në shkresa të lëndës, dëshmohet një pretendim i tillë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave, si dhe vlerësimit të tyre, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, duke refuzuar kërkesëpadinë e paditësit.

Në arsyetimin e aktgjykimin të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se pas shqyrtimit dhe administrimit te provave të propozuara nga ndërgjyqësit, ka rezultuar gjendja faktike që janë hedhur disa mbeturina në pronën nr. ...-0., për këtë inspektorati komunal ka evidentuar një gjë të tillë, mirëpo të njëjtat janë larguar dhe nuk paraqesin rrezik për ndotje ambienti, po ashtu nuk vërehen dëmi që i është shkaktuar, ngase është bërë pastrimi. Gjykata ka bërë dëgjimin e dëshmitarit J. B., përmes së cilës ka arsyetuar se paditësi pronën në kontest e kishte blerë prej axhës dhe gjyshit të tij, kurse në të ka hyrë në posedim prej vitit 1985 të cilën e shfrytëzon pa pengesa, arsyetim të njëjtë ka dhënë gjykata edhe për sa i përket dëshmisë së dëshmitarit M. J..

Po ashtu gjykata ka arsyetuar se ka obliguar paditësin të paraqes prova për të vërtetuar dëmin që ka pretenduar se i është shkaktuar, mirëpo ai vetëm ka bërë precizin e kërkesëpadisë, po ofruar prova për këto pretendime. Prandaj në mungesë të provave kërkesëpadia e paditësit rezultoi si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Aktgjykimi nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktgjykimit është i qartë dhe për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë janë dhënë arsye. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Po ashtu rezultoi si i pa bazuar pretendimi ankimor i paditësit në lidhje me shkeljen nga neni 182 par.2 pika (i) që lidhet me mos dhënien e mundësisë për shqyrtimin e çështjes në gjykatë. Përgjatë procedurës gjyqësore paditësit nuk i është mohuar qasja në gjykatë apo përdorimi i të drejtave procedurale me qëllim të argumentimit të së drejtës së tij, si dhe përdorimit të mjeteve provuese sipas propozimit. Madje gjykata e shkallës së parë, i kishte pyetur nëse kanë propozime që lidhen me përfundimin e ndonjë ekspertimi apo daljen e gjykatës në këqyrje në vend.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor. Gjykata e shkallës së parë pasi kishte administruar provat, kishte arritur të vërtetoj gjendjen faktike për sa i përket fakteve se prona në të cilin paditësi pretendon se është shkaktuar dëmi, nuk evidentohet në emër të tij, porse në emër të personave të tretë të cilët nuk janë palë në këtë proces, gjithashtu nga certifikata e pronësisë është vërtetuar se kjo pronë gjendet në pronësi të një personi të tretë. Faktin se paditësi e kishte blerë këtë pronë, e kishte vërtetuar përmes dëgjimit të dëshmitarëve, mirëpo në kuptim të qenurit pronar, paditësi nuk e ka këtë cilësi. Gjykata e shkallës së parë ka bërë administrimin e procesverbalit të kryer nga Inspektorati Komunal, datë 22.11.2012 përmes të cilit kishte vërtetuar se ka pasur të hedhura mbeturina nga “V.”, mirëpo të njëjtat janë larguar dhe nuk paraqesin kurrfarë ndotje të ambientit, gjithashtu nuk vërehen dëme të shkaktuara. Bazuar në ato prova që janë propozuar nga palët ndërgjyqëse, gjykata e shkallës së parë ka paraqitur edhe arsyetimin, duke pasur parasysh, se kontesti i tillë udhëhiqet nga parimi se ndërgjyqësit janë ata që duhet të ofrojnë prova dhe propozime, me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike. Me mënyrën që gjykata e shkallës së parë ka arritur në përfundim për gjendjen faktike pajtohet edhe kjo gjykatë, ngase faktet që përbejnë aspektet kyçe të kontestit janë vërtetuar.

Bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar drejtë, gjykata e shkallës së parë ka arritur që të bëjë vlerësimin e saj drejtë, ndonëse për këtë gjë nuk ka cekur një normë të caktuar materiale. Nga analizimi i thënieve në ankesë, nuk është gjendur se cilat ishin ato prova që gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar në mënyrë të gabuar, në atë mënyrë që ka keqinterpretuar përmbajtjen e tyre, apo se nuk është vërtetuar plotësisht gjendja faktike, duke bërë të njohur për këtë gjykatë se një provë e caktuar do të dërgonte tek një gjendje tjetër faktike.

Gjykata e Apelit vlerësoi pretendimin ankimor në mënyrën e elaboruar nga pala ankuese, për sa i përket aplikimit të së drejtës materiale, ndonëse për këtë gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, duke gjetur si pretendim të pa bazuar. Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, Gazeta Zyrtare nr.29/78 (i aplikuar në Kohën kur pretendohet të jetë shkaktuar dëmi), në nenin 154 par. 1 të LMD-së parashihet se *“Kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij.”* Ndërsa me dispozitën e nenit 158 parashihet se *“Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia.”* Bazuar në gjendjen faktike që ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë, nuk rezultoi të jetë fakt i provuar se me veprimet e të paditurës, gjegjësisht të personit që ka punuara tek e paditura, të jenë shkaktuar dëm në paluajtshmërinë që paditësi pretendon. Për më tepër, nga procesverbali i inspektimit të vendit të ngjarjes, ka rezultuar se nuk kishte dëme të pësuar në paluajtshmërinë që paditësi pretendon. Gjykata e Apelit vlerëson se tek rastet e dëmit jashtëkontraktual siç është rasti kontestues, duhet të plotësohen disa kushte siç janë: a) ekzistenca e dëmit, b) ekzistenca e paligjshmërisë së veprimit ose të mosveprimit, c) ekzistenca e fajit, dhe d) ekzistenca e lidhjes shkakësore midis veprimit ose mosveprimit dhe dëmit të ardhur. Rrjedhimisht, tek ky rasti nuk është përmbushur asnjë element që do të tërhiqte pas vetes edhe fajin më pastaj. Neni 319 par. 1 i LPK-së rregullon *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*. Përmes kësaj norme është rregulluar parimi i shqyrtimit që është themelor në procedurë kontestimore, ashtu që gjykata do të vendos mbi bazë të materialit procedural provues, që kanë ofruar palët në procedurë. Gjykata ka pyetur palët për provat që pretendojnë të ofrojnë për argumentin pretendimeve të tyre, kurse paditësi nuk arriti të argumentoj dëmin pasuror që pretendohet të jetë shkaktuar, të cilat gjendeshin në pronën që ai posedonte dhe për të cilat kishte pronësi. Ekzistimi i një të drejte në kuptimin material, shikuar nga perspektiva e ligjit procedural nënkupton se palët duhet të paraqesin prova për vërtetimin e fakteve. Rrjedhimisht gjykata e shkallës së parë ka arritur në përfundim të rastit duke aplikuar rregullat mbi barrën e të provuarit. Kjo gjykatë vlerëson të theksoj se sjella e paditësit në kuptim të legjitimitetit aktiv për të kërkuar dëmin që pretendohet se i është shkaktuar me veprimet e të paditurës, nuk është bërë nga prizmi i autorizimeve që ai ka si pronar i sendit-paluajtshmërisë, porse është vlerësuar nga prizmi i dëmit që ka mundur t’i bëhet nga dëmtimi i sendeve që ai ka pasur të vendosura në pronën në kontest. Ky vlerësim vie nga fakti se ai nuk ka të drejtën e pronësisë mbi sendin, prandaj ai nuk mund t’i shfrytëzoj autorizimet e pronarit të sendit në kuptim të ushtrimit të të drejtave sendore lidhur me të.

Në analizim të pretendimeve ankimore, Gjykata e Apelit nuk ka gjetur ndonjë vlerësim tjetër, për vendosjen ndryshe nga siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykatës së Apelit i rezultoi se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL**  
**Ac.nr.1347/2021, datë 13.06.2024**

**Kryetari i Kolegjit, Gjyqtari**  
**Dardan Kadolli**